



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:245140

Datë: 23.08.2024

Numri i dokumentit: 06081207

**AC-I-23-0237-A0001- A0002**

**Në ankesën e**

***Paditësit/ankuesit***

**G A, R F, M H, M R, Sh B dhe Sh M** ish punëtor të NSH FAN "Zahir Pajaziti"- të përfaqësuar nga avokati B I, Prishtinë.

**Kundër**

***E paditura/Ankuesja***

**N.SH FAN "Zahir Pajaziti"**, Podujevë (në Likuidim) e cila është e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishtë, Prishtinë.

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe, Hasim Sogojeva gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës dhe të paditësve të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-1536 të datës 04 prill 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 23 gusht 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e të paditurës/ankueses refuzohet si e pabazuar.**
- 2. Ankesa e paditësve/ankuesve aprovohet si e bazuar.**

- 3. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-14-1536 i datës 04 prill 2023 vetëm sa i përket çështjes së kamatës për paditësit G A, R F, M H, M R, Sh B dhe Sh M**
- 4. Obligohet e paditura që paditësve ti njeh edhe interesin ligjor prej 10% të shumës themelore nga shuma bruto që i është njohur në emër të kompensimit si në piken 2 dispozitivit të Aktgjykimit të shkallës së parë C-IV-14-1536 dhe atë si në vijim:**
  - **G A i njihet interesi ligjor në shumë prej 158.23 euro,**
  - **R F i njihet interesi ligjor në shumë prej 190.41 euro,**
  - **M H i njihet interesi ligjor në shumë prej 52.73 euro,**
  - **M R i njihet interesi ligjor në shumë prej 98.19 euro,**
  - **Sh B, i njihet interesi ligjor në shumë prej 196.61 euro,**
  - **Sh M i njihet interesi ligjor në shumë prej 356.13 euro, të cilat shuma do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.**
- 5. Obligohet e paditura që përfaqësuesit të paditësve t'ia paguaj shpenzimet për hartimin e ankesës në shkallën e dytë në shumë prej 208 euro si dhe shpenzimet për pagesën e taksës për ankesë në shumë prej 30 euro.**
- 6. Pjesa tjetër e dispozitivit të aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-1536 të datës 04 prill 2023, mbetet e pandryshuar.**
- 7. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike:**

Me 14 mars 2014, përfaqësuesi i paditësve av. B I ka dorëzuar ankesën për shqyrtimin e Vendimeve të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) për paditësit e theksuar si në vijim: I K nr i vendimit PRN046 – 0679, G A nr. i vendimit PRN046 – 0796, R F nr. i vendimit PRN046 – 0576, M H nr. i vendimit PRN046 – 0714, M R r. i vendimit PRN046 – 0692, Sh B nr. i vendimit PRN046 – 0639, Sh M nr i vendimit PRN046 – 0934.

Në ankesën e tij dhe në parashtresat tjera gjate procedurës me shkrim përfaqësuesi i paditësve thekson se të gjithë punëtorët ishin pre e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga ndërmarrja dhe rrjedhimisht të gjithë kanë të drejtë në kompensim

për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës. AKP nuk ua kishte mohuar këtë, por AKP ua ka refuzuar kërkesat e tyre duke pretenduar se këto kërkesa për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës janë të parashkuara. Përfaqësuesi i paditësve konsideron se kërkesat e punëtorëve nuk janë të parashkuara dhe se punëtorët e kësaj ndërmarrje kanë të drejtë në kompensim për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, duke përfshirë edhe kamatën, duke ju referuar ligjeve që janë në fuqi në Kosovë.

Së bashku me ankesë përfaqësuesi i paditësve si prova ka bashkëngjitur vendimet e AL, njoftimet lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës dt. 24.03.2006, kopjet e Librezës së Punës si dhe dëshmi tjetra siç janë kopjen e listës së pagave, si dhe letërnjoftimet për paditësit.

Me 01 qershor 2021, e paditura AKP parashtroi mbrojtje në të cilën pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të drejtë të dispozitave ligjore. E paditura pohoi se ankesa është e pa pranueshme pasi që konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekti i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria. Në këtë kontekst 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimet se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Paditësit nuk kanë treguar se cilin nen e ka shkelur të Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL-ja me marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 të Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimet se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në.

Argumenti tjetër në përgjigjen e parashtruar të AKP-së është se Pretendimet e parashtruesve për kompensim për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës janë të parashkuara.

Në bazë të nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në dhe nenit 608 të Ligjit për punë të bashkuar i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24, parashikon që "pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër e punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës do të jetë e parashkuar për tre vjet. Në varësi të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë parashtruar në gjykatë apo autoritet tjetër kompetent brenda 3 vjetësh nga koha kur parashtruesi ka fituar të drejtën të kërkoj dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të punës në qershor 2008.

Në fund e paditura AKP propozon gjykatën që ankesa të refuzohet si e pa pranueshme dhe pa bazuar dhe kërkon të vërtetohen vendimet e AL-së në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit nr. 06/L-086.

Me 21 korrik 2021, Shkalla e parë ka kërkuar me një urdhër nga përfaqësuesi i paditësve av. B I të bëjë specifikimin e saktë të shumës së kërkuar për secilin ankues dhe të dorëzoj prova shtesë në mbështetje të shumës së kërkuar.

Me 09 gusht 2021, përfaqësuesi i paditësve paraqet përgjigjen në urdhrin e lartcekur, duke specifikuar për secilin ankues shumën e kërkuar.

Më 04 prill 2023, Shkalla e parë e DHPGJS-së ka marrë aktgjykimin C-IV.-14-1536 me të cilin aprovohen ankesat si të bazuar dhe ndryshohen vendimet e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së 1) PRN046-0679 të dt. 12.02.2014, 2) PRN046-0796 të dt.24.02.2014, 3) PRN046-0576 të dt.10.02.2014, 4) PRN046-0714 të dt.24.02.2014, 5) PRN046-0692 të dt. 24.02.2014, 6) PRN046-0639 të dt. 12.02.2014, 7) PRN046-0934 të dt. 26.02.2014. Ka obliguara të paditurën AKP, që paditësve:

I K - në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,846.56€, dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore ti paguaj shumën 184.65 €.

G A- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,582.38€.

R F- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,904.10€.

M H- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 527.36€.

M R- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 981.96€.

Sh B- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,966.14€.

Sh M- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 3,561.36€, te cilat shumat do të përmbushen në pajtim të

prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Gjithashtu ka obliguar të paditoren AKP, që përfaqësuesit të paditësve t'ia paguaj shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës për: 1) kërkesën ndaj AL-së në shumën prej 52€, 2) shqyrtimin e shkresave të lëndës në shumë prej 52€, 3) hartimin e padisë në shumë prej 104€, 4) kundërshtimin e mbrojtjes së AKP-së në shumë prej 104€, pra gjithsejtë 312€, si dhe kompensimin e shumës për taksa gjyqësore në vlerë prej 20€.

Shkalla e parë ka konstatuar se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se paditësit ishin punëtorë të NSH "Fan Zahir Pajzaiti". Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së paditësve për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e paditësve duke pretenduar se të njëjtat janë parashkruar, me arsyetim se paditësit nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Paditësit , bazën e kërkesës së tyre e mbështesin në listën e pagave të punëtorëve të llogaritura për tre muaj e datës 31 mars 2006 dhe në librezën e punës.

Shkalla e parë ka konstatuar se nga librezja e punës vërtetohet fakti se paditësi I K ka krijuar marrëdhënie pune ne NSH "Fan Zahir Pajzaiti" dhe kishte 21 vite përvojë pune. Nga lista e pagave e datës 31 mars 2006 ishte vërtetuar fakti se NSH "Fan Zahir Pajzaiti", punëtorit I K i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1,846.56 €. Duke zbatuar nenin 76 të Ligjit të Punës dhe pas shumëzimit të 6 pagave mujore prej secila dhe lartësisë të pagës 307.76 euro, mund të përfundohet se detyrimi i të paditurës për kompensimin e ndërprerjes është 1,846.56 euro.

Nga librezja e punës vërtetohet fakti se paditësi G A kishte krijuar marrëdhënie pune ne NSH "Fan Zahir Pajzaiti" dhe kishte 21 vite përvojë pune. Nga lista e rrogave e datës 31 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH "Fan Zahir Pajzaiti", punëtorit G A i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1,582.38 €. Duke zbatuar nenin 76 të Ligjit të Punës dhe pas shumëzimit të numrit të pagave prej 6 dhe lartësisë mujore të pagës 263.73 euro, mund të përfundohet se detyrimi i të paditurës për kompensimin e ndërprerjes është 1,582.38 euro.

Nga librezat e punës vërtetohet fakti se paditësi R F kishte krijuar marrëdhënie pune ne NSH "Fan Zahir Pajzaiti" dhe kishte 21 vite përvojë pune. Nga lista e rrogave e datës 31 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH "Fan Zahir Pajzaiti", punëtorit R F i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1,904.10€. Duke zbatuar nenin 76 të Ligjit të Punës dhe pas shumëzimit të numrit të pagave prej 6 dhe lartësisë mujore të pagës 317,35euro, mund të përfundohet se detyrimi i të paditurës për kompensimin e ndërprerjes është 1,904.10 euro.

Shkalla e parë ka konstatuar se nga provat e prezantuara vërtetohet fakti se paditësi M H kishte krijuar marrëdhënie pune ne NSH "Fan Zahir Pajzaiti" dhe kishte 6 vite përvojë pune. Nga lista e rrogave e datës 31 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH "Fan Zahir Pajzaiti", punëtorit M H i ka mbetur borxh pagat në shumë prej 527.36€. Duke zbatuar nenin 76 të Ligjit të Punës dhe pas shumëzimit të numrit të pagave prej 2 dhe lartësisë mujore të pagës 263.68 euro, mund të përfundohet se detyrimi i të paditurës për kompensimin e ndërprerjes është 527.36 euro.

Nga provat e prezantuara vërtetohet fakti se paditësi M R kishte krijuar marrëdhënie pune ne NSH "Fan Zahir Pajzaiti" dhe kishte 19 vite përvojë pune. Nga lista e rrogave e datës 31 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH "Fan Zahir Pajzaiti", punëtorit M R ka mbetur borxh pagat në shumë prej 981.96€. Duke zbatuar nenin 76 të Ligjit të Punës dhe pas shumëzimit të numrit të pagave prej 3 dhe lartësisë mujore të pagës 327,32 euro, mund të përfundohet se detyrimi i të paditurës për kompensimin e ndërprerjes është 981,96 euro.

Nga provat e prezantuara vërtetohet fakti se paditësi Sh B kishte krijuar marrëdhënie pune ne NSH "Fan Zahir Pajzaiti" dhe kishte 22 vite përvojë pune. Nga lista e rrogave e datës 31 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH "Fan Zahir Pajzaiti", punëtorit Sh B ka mbetur borxh pagat në shumë prej 1,966.14€. Duke zbatuar nenin 76 të Ligjit të Punës dhe pas shumëzimit të numrit të pagave prej 6 dhe lartësisë mujore të pagës 327,69 euro, mund të përfundohet se detyrimi i të paditurës për kompensimin e ndërprerjes është 1,966.14 euro.

Nga provat e prezantuara vërtetohet fakti se paditësi Sh M kishte krijuar marrëdhënie pune ne NSH "Fan Zahir Pajzaiti" dhe kishte 22 vite përvojë pune. Nga lista e rrogave e datës 31 mars 2006 gjykata vërteton faktin se NSH "Fan Zahir Pajzaiti", punëtorit Sh M ka mbetur borxh pagat në shumë prej 3,561.36€. Duke zbatuar nenin 76 të Ligjit të Punës dhe pas shumëzimit të numrit të pagave prej 6

dhe lartësisë mujore të pagës 593.56 euro, mund të përfundohet se detyrimi i të paditurës për kompensimin e ndërprerjes është 3,561.36 euro.

Shkalla e parë i ka pranuar si prova relevante dhe të bazuara provat e bashkëngjitura nga paditësit, siç janë listën e pagave, njoftimet lidhur me ndërprerjen e marrëdhënien e punës për të arritur në përfundim se paditësit kanë ofruar shërbime punë për NSh për periudhën e lartcekur dhe se për këtë periudhë NSh i ka mbetur borxh pagat. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësit nuk kishte ofruar shërbime pune për NSh në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave lëshuar nga personi përgjegjës i NSh-së.

Shkalla e parë ka arsyetuar se ne bazë të Rregullores nr. 2001/27 Per Ligjin Themelore të Punës, në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme: *(i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;(ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;(iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;(iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;(v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore*

Shkalla e parë ka vlerësuar se ndërprerja e parashkrimit të kërkesave të paditësve është bere me njoftimin e datës 24 mars 2006, ku paditësit ishin njoftuar se punësimi i tyre përfundon me rastin e privatizimit të NSh-së dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSh-së, duhet ta parashtrojë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSh-së. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave ( AC-I-20-0304, AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168 , AC-I-20-0183 etj).

Po ashtu Shkalla e parë i ka njohur përfaqësuesit të paditësve shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës.

Me 24 prill 2023, përfaqësuesi i paditësve ka parashtruar në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-1536 të datës 04 prill 2023, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar vetëm sa i përket çështjes së kamatës ose lënda të kthehet në rigjykim tek gjyqtari individual i DHPGJSK-së. Të detyrohet e paditura

që paditësve t'ia paguajë kamatën prej 10% për secilën shumë themelore të miratuar sipas aktgjykimit C-IV.-14-1536 të datës 04 prill 2023. Në ankesën e parashtruar pranë kolegjit të Apelit, përfaqësuesi i paditësve/ankuesve ka theksuar se në bazë të padisë grupore krahas borxhit kryesor është kërkuar edhe kamat ligjore për secilin paditës, mirëpo në momentin e miratimit të padisë Gjykata vetëm për paditësin I K ka vendosur lidhur me çështjen e kamatës duke ia njohur interesin ligjor prej 10 % të shumës themelore, ndërsa për paditësit tjetër nuk është vendosur lidhur me kamatën duke u bazuar në këto shuma themelore.

Tutje ka shtuar se Kërkesa mund të përfshijë kamatën para datës së Vendimit të Likuidimit. Vendimi i Likuidimit është vendim i marrë nga ana e Bordit të Agjencisë për inicimin e likuidimit. Vendimi i Likuidimit është vendim i marrë nga ana e Bordit të Agjencisë për inicimin e likuidimit. Vendimi i Likuidimit është Vendim i marrë nga ana e Bordit të Agjencisë për inicimin e likuidimit.

Më 28 prill 2023, ka parashtruar ankesë pranë Kolegjit të Apelit me të cilën ka propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar duke i refuzuar ankesat kundër vendimit të autoritetit të likuidimit si të pa bazuara dh ta vërtetojë vendimin e ankimuar. E paditura ka shtuar se i qëndron të gjitha pohimeve dhe qëndrimeve të parashtruara më parë përballë kolegjit të Specializuar( në Mbrojtje). E paditura thekson se mbanë qëndrimin që të gjitha ato pretendime duhen të shqyrtohen de novo nga Kolegji i Apelit ndërsa saktësimet e mëposhtme përbejnë një shtesë ndaj tyre.

E paditura thekson se Gjykata ka vlerësuar se si Ligji në fuqi në lidhje me kërkesën për pagesën e pagave të pa paguara është Ligj i punës i Republikës së Kosovës 03/L-212 që ka hyrë në fuqi më 17 Dhjetor të vitit 2010, që me nenin 55 ka rregulluar me nenin 87. "të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhet brenda afatit prej 3 vitesh".

Për më tepër në ankesë e paditura ka pohuar se Gjykata e Shkallës së I-rë është tërësisht jashtë kontestit faktit të çështjes. Autoriteti i Likuidimit ka vërejtur që Gjykata i ka ngatërruar dy çështje krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra përkatësisht dy afate të ndryshme dhe atë afatin për parashtrimin e kërkesave që është afat procedural për të dorëzuar dëshminë e kërkesës në procedurën e likuidimit dhe afatin ligjor për të kërkuar mbrojtjen e të drejtës së pretenduar-afatin e parashkrimit i cili në këtë rast është 3 vjet në bazë të nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Këto dy afate janë të ndara dhe të dallueshme të cilat duhet të



përmbushen nga çdo pretendues në mënyrë që të pranohet kërkesa. Tutje AKP-ja ka pretenduar se kërkesa për 3 paga të fundit të papaguara është dashtë të paraqitet brenda tre viteve nga viti 2006, prej kur paditësi nuk ka përfituara të ardhura personale, që nënkupton se kërkesa është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Me 08 korrik 2024, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS një parashtrësë dhe i përgjigjet ankesës së paditësve. Në këtë parashtrësë AKP-ja i kundërshton pretendimet ankimore të paditësve duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP konsideron se përmes mbrojtjes ajo i ka sqaruar argumente e saj mjaftueshëm dhe se përmbahet nga përsëritja e të njëjtave. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi ankimuar.

Më 01 korrik 2024, Gjykata ka lëshuar urdhër për paditësit të cilët mund të parashtrojnë përgjigje ndaj ankesës së AKP-së por të njëjtit nuk kanë parashtruar deri në marrjen e këtij aktgjykimi.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa e paditësve është e bazuar, ndërsa ankesa e të paditurës -AKP-së refuzohet si pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, është pjesërisht i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj i njëjti duhet të ndryshohet vetëm sa i përket çështjes së kamatës, ndërsa pjesa tjetër e tij vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit pranë Autoritetit të Likuidimit kërkesa për ndërprerje të parakohshme të kontratës, të cilat janë refuzuar si të pa vlefshme për kompensimin e ndërprerjes së parakohshme me arsyetimin se të njëjtat janë parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-1536 të dt.04 prill 2023, ankesën e paditësve e ka aprovuar si të bazuar, i ka ndryshuar vendimet e Autoritetit të Likuidimit të AKP-së 1) PRN046-0679 të dt. 12.02.2014, 2) PRN046-0796 të dt.24.02.2014, 3) PRN046-0576 të dt.10.02.2014, 4) PRN046-0714 të dt.24.02.2014, 5) PRN046-0692 të dt. 24.02.2014, 6) PRN046-0639 të dt. 12.02.2014, 7) PRN046-0934 të dt. 26.02.2014. Ka obliguara të paditurën AKP, që paditësve:

I K - në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,846.56€, dhe në emër të interesit ligjor prej 10% të shumës themelore ti paguaj shumën 184.65 €.

G A- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,582.38€.

R F- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,904.10€.

M H- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 527.36€.

M R- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 981.96€.

Sh B- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 1,966.14€.

Sh M- në emër të kompensimit për ndërprerje të parakohshme t'i paguaj shumën prej 3,561.36€, te cilat shumat do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit. Gjithashtu ka obliguar të paditurën AKP, që përfaqësuesit të paditësve t'ia paguaj shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës për: 1) kërkesën ndaj AL-së në shumën prej 52€, 2) shqyrtimin e shkresave të lëndës në shumë prej 52€, 3) hartimin e padisë në shumë prej 104€, 4) kundërshtimin e mbrojtjes së AKP-së në shumë prej 104€, pra gjithsejtë 312€, si dhe kompensimin e shumës për taksa gjyqësore në vlerë prej 20€.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje të Shkallës së I-rë, nuk mund të pajtohet me konstatimin e gabuar të Autoritetit të Likuidimit dhe pretendimin e saj ankimore se kërkesat e paditësve janë parashkruar.

Kolegji i Apelit vëren se paditësit në procedurën pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, kanë sjellë Njoftimet zyrtar të ish AKM-së me të cilën vërtetohet se atyre i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 24 mars 2006. Këto njoftime e kanë ndërprerë afatin e parashkrimit të kërkesave. Në bazë të këtyre njoftimeve, atë ditë është shitur Ndërmarrja në bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së, dhe marrëdhënia e punës së paditësve është ndërprerë menjëherë. Në këto njoftim thuhej "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësin e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura".

Paditësit duke u bazuar në këtë njoftim kanë pritur të filloj procedura e likuidimit ndaj NSH-së, dhe pastaj të paraqesin kërkesën për paga. Paditësit në afatin ligjor kanë paraqitur kërkesat e tyre tek Autoriteti i Likuidimit. Andaj nuk mund të konsiderohet se kërkesat janë parashkruar.

Ankuesit/paditësit, bazën e kërkesës e mbështetin në kopjet e librezës së punës, njoftimin e datës 24 mars 2006, listës përfundimtare të pemëtoreve që i kanë, si dhe në pohimet e tyre të parashtruara në ankesë. Nga librezat e punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se paditësit kishin krijuar marrëdhënie pune në NSH FAN "Zahir Pajaziti", deri në kohën kur edhe u privatizua NSH-ja. Po ashtu, nga njoftimet mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 24 mars 2006 vërehet se paditësit kishin qenë punëtor të NSH-së deri në ditën e privatizimit dhe se me këtë letër ishte njoftuar se punësimi i tij përfundon me rastin e privatizimit të NSH me datë 24 mars 2006.

Andaj, me të drejtë Shkalla parë e DHPGJS i ka konsideruar si prova relevante librezat e punës, njoftimin e datës 24 mars 2006 lëshuar nga vet AKP, për vërtetimin e faktit se paditësit kanë qenë punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se paditësit nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i ka mbetur pagat borxh, ashtu siç përshkruhen në listën e pagave nga personi përgjegjës i NSH-së.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e parë ka zbatuara saktë dhe drejtë dispozitat ligjore në fuqi përkatësisht Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 Per Ligjin Themelore te Punës, në rastet e largimit të shkallës së gjerë nga puna zbatohen dispozitat e mëposhtme:(dh) punonjësi nuk mund të largohet nga puna derisa punëdhënësi të mos ia ketë paguar atij një dëmshpërblim të njëkohshëm. Dëmshpërblimi duhet t'i paguhet punonjësit në datën e shkëputjes së kontratës së punës sipas shkallës së mëposhtme: (i) prej 2 deri në 4 vjet stazh 1 pagë mujore;(ii) prej 5 deri në 9 vjet stazh 2 paga mujore;(iii) prej 10 deri në 19 vjet stazh 3 paga mujore;(iv) prej 20 deri në 29 vjet stazh 4 paga mujore;(v) 30 vjet stazh e më tepër 5 paga mujore.

Kolegji i Apelit vëren se Shkalla e parë ia ka njohur interesin ligjor prej 10 % vetëm paditësit të parë I K, ndërsa paditësve te tjerë nuk i ka njohur dhe as nuk e ka refuzuar pjesën e kërkesës për interesin ligjor edhe pse në fakt interesi ligjor ka qenë kërkesë e paditësve nga paraqitja e ankesës fillestar. Në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi që paditësit janë tërhequr nga interesi ligjor, andaj kërkesa e paditësve për njohjen e interesit është e bazuar, meqë atyre i është njohur e drejte e kompensimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ndërsa aktgjykimi i kundërshtuar duhet të ndryshohet vetëm sa i përket çështjes së interesit ligjor.

Kolegji i Apelit vlerëson se bazë të nenin 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP- e paditëseve duhet ti njihet edhe interesi ligjor prej 10% të shumës themelore nga shuma bruto që i është njohur në emër të kompensimit si në pikën 2 dispozitivit të Aktgjykimit të kundërshtuar C-IV-14-1536 dhe atë për këta paditës si në vijim:

G A i njihet interesi ligjor në shumë prej 158.23 euro,  
R F i njihet interesi ligjor në shumë prej 190.41 euro,  
M H i njihet interesi ligjor në shumë prej 52.73 euro,  
M R i njihet interesi ligjor në shumë prej 98.19 euro,  
Sh B, i njihet interesi ligjor në shumë prej 196.61 euro,  
Sh M i njihet interesi ligjor në shumë prej 356.13 euro, të cilat shuma do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Gjithashtu obligohet e paditura AKP, që përfaqësuesit të paditësve t'ia paguaj shpenzimet për hartimin e ankesës në shumë prej 208 euro si dhe shpenzimet për pagesën e taksës për ankesë në shumë prej 30 euro.

Kolegji i Apelit ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Prandaj duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apelit vjen në përfundim se ankesa e paditësve ishte bazuar, ndërsa ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Paditësit/ankuesit dhe e paditura/ankuesja tashmë i kanë paguara taksat gjyqësore, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 23 gusht 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues

\_\_\_\_\_